**L I G J**
**Nr.8099, datë 28.3.1996**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7926, DATË 20.4.1995 "PËR TRANSFORMIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8067, DATË 15.2.1996**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me ligjin nr.8067, datë 15.2.1996, në fund të nenit 6 shtohet një shprehje me këtë përmbajtje:

"Mënyra e vlerësimit të pasurisë së shoqërive të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të përdorura që transformohen, bëhet me miratim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit dhe Ministrisë së Financave".

Në nenin 8, në fund të paragrafit të dytë, shtohet një shprehje me këtë përmbajtje:

"Për ndërmarrjet e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të përdorura, një e treta e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës do të emërohen nga Ministria e Ndërtimit dhe Turizmit, një e treta nga Ministria e Financave dhe një e treta nga pushteti lokal përkatës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.1459, datë 9.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha**